

Phillips: Kosovës i mungon pjekuria politike për të qenë partnere strategjike



FAQE 8

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KATËR VJET PAS LARGIMIT TË PROKURORËVE SERBË, KOSOVA PËRGATIT KONKURS TË RI

FAQE 4-5



Gati katër vjet pasi dhjetëra gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës administrativë serbë u larguan nga institucionet e drejtësisë në veri të Kosovës, autoritetet po përgatiten të nisin një proces të ri

për plotësimin e vendeve të mbetura bosh. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) konfirmon për Radion Evropa e Lirë se është duke përgatitur konkursin për rekrutimin e prokurorëve nga rad-

hët e komunitetit serb, pasi ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, dekretoi lirimin nga detyra të shtatë prokurorëve serbë që kishin dhënë dorëheqje në vitin 2022

IKD NIS NISMËN PËR NDRYSHIMIN E KODIT PENAL, DUHEN 10 MIJË NËNSHKRIME PËR TA ÇUAR NË KUVEND

F. 3



RAPORTI I D+: PROCEDURAT E PROKURIMIT PREJ 22.5 MILIONË EUROSH U SHOQËRUAN ME SHKELJE DHE ZVARRITJE

F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



TAKIMI RUBIO - LAVROV PËR LUFTËN NË UKRAINË MBARON PA NDONJË PËRPARIM E ME PAK OPTIMIZËM

F. 2

AKK-ja KUNDËRSHTON PROJEKTILIGJIN PËR PRONËN PUBLIKE: PO CENOHEN KOMPETENCAT E KOMUNAVE

F. 7

KUVENDI I JASHTËZAKONSHËM I LDK-së NË "DISKRECION" TË ABDIXHIKUT

F. 6

EKONOMI



NË QERSHOR KOSOVA EKSPORTOI 102 MILIONË EURO MALLRA, IMPORTOI MBI 680 MILIONË EURO

F. 8

NJË HAP I RËNDËSISHËM NË BASHKËPUNIMIN NDËRMJET KOSOVËS DHE GJERMANISË PËR VEPRIMIN KLIMATIK DHE TRANZICIONIN ENERGJETIK

F. 8

SPORT



BALLKANI MPOSHTET NË DUBLIN, POR KUALIFIKIMI MBETET I HAPUR

F. 10

TAKIMI RUBIO - LAVROV PËR LUFTËN NË UKRAINË MBARON PA NDONJË PËRPARIM E ME PAK OPTIMIZËM

UASHINGTON, 23 KORRIK - Diplomatat më të lartë të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë u takuan të enjten duke ringjallur përpjekjet për t'i dhënë fund luftës së Moskës në Ukrainë e cila ka hyrë në vitin e pestë. Megjithatë, të dyja palët lanë të kuptojë se nuk pati ndonjë përpërim të ri apo arsye për optimizëm.

Takimi mes sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, dhe ministrit të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, u zhvillua në një kohë kur përpjekjet e ShBA-së për të ndërmjetësuar një marrëveshje paqeje janë bllokuar, pasi administrata Trump ka zhvendosur vëmendjen te lufta me Iranin, dhe Kremli nuk ka dhënë asnjë shenjë se po zbut kërkesat lidhur me luftën.

Pas takimit, i cili zgjati vetëm 35 minuta, Rubio i përshkroi bisedimet si “të mira” dhe “të sqarta”, por tha se do të nevojiten propozime të reja, pasi idetë e mëparshme për paqe nuk kanë dhënë fryt.

Ai nuk pranoi të japë hollësi. “Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të luajnë rol konstruktiv për t'i dhënë fund një lufte të pakuptimtë”, tha Rubio për Radion Evropa e Lirë. I pyetur nëse takimi ka sjellë ndonjë përpërim, Rubio hodhi poshtë pritshmëritë për përpërim të shpejtë. “Mendoni se e zgjidhëm luftën në Ukrainë gjatë 30 minutave tona këtu në Azi? Nuk funksionon kështu”, tha ai.

Më vonë, kur Radio Evropa e Lirë e pyeti Lavrovin se kur do ta ndalojë luftën Rusia, ai ose e injoroi pyetjen, ose nuk e dëgjoi. Në një deklaratë, Ministria e Jashtme e Rusisë tha se Lavrovi shprehu pakënaqësinë e Moskës



për furnizimet amerikane me armë për Ukrainën dhe akuzoi aleatët evropianë të Ukrainës për “politika destabilizuese”, të cilat synojnë një “humbje strategjike” të Rusisë.

Sipas Ministrisë, Lavrovi e ngriti edhe çështjen e një takimi mes presidentëve Donald Trump dhe Vladimir Putin në Alaskë.

Kremli ka këmbëngulur se Trumpi dhe Putini kishin arritur në Alaskë marrëveshje të rëndësishme për përfundimin e luftës në Ukrainë. Rubio dhe zyrtarë të tjerë amerikanë e kanë mohuar vazhdimisht këtë pretendim. “Do të duhet të gjejmë sugjerime dhe ide të reja”, u tha Rubio gazetarëve. “Sigurisht, ajo që ishte propozuar më parë nuk ishte e pranueshme për Ukrainën në atë kohë dhe nuk besoj se është e pranueshme as tani. Madje, ndoshta, është edhe më pak e pranueshme”. Sipas Rubios, çdo marrëveshje e mundshme paqeje ka gjasa të kërkojë “ide të reja dhe disa koncepte të reja”.

Ai tha se Uashingtoni është i

gatshëm të kontribuojë me propozime “nëse paraqitet mundësia dhe kushtet janë të përshtatshme”.

I pyetur për takimin Rubio - Lavrov, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u tha gazetarëve se Moska nuk ishte tepër optimiste.

Në fushëbetë, trupat ukrainase kanë arritur t'i ndalin përpërimet e forcave ruse, të cilat vazhdojnë të çajnë përpërim me ritëm shumë të ngadaltë, duke pësuar humbje jashtëzakonisht të mëdha. Fushata ukrainase me dronë me rreze të gjatë veprimi ka goditur rëndë rafineritë ruse të naftës, ndërsa Rusia vazhdon t'i shkatërrojë qytetet ukrainase me raketa balistike dhe dronë. Mes kërkesave të tjera, Rusia vazhdon të ngulë këmbë në kontroll të plotë mbi pjesët e pushtuara të Ukrainës lindore, ndërsa Kiev refuzon çdo lëshim territorial.

Rubio tha se Rusia po humb “mbi 5 000 deri në 6 000 ushtarë në javë”, ndërsa theksoi se edhe

Ukraina ka paguar “një çmim të jashtëzakonshëm”, duke përmendur viktimat civile dhe shtimin e sulmeve ndaj Kievit. Ai tha se si Rusia ashtu edhe Ukraina kanë arsye të forta për t'i dhënë fund luftës, por pengesa kryesore mbetet gjetja e kushteve që janë të pranueshme për të dyja palët. “Kjo ka qenë sfida: një fund që të dyja palët mund ta pranojnë”, tha ai.

Propozimet e mëparshme, të pazbatueshme

Që nga fillimi i pushtimit të plotë rus në shkurt të vitit 2022, Uashingtoni ka qenë furnizuesi më i madh individual i Ukrainës me armë dhe pajisje ushtarake. Ky furnizim është ngadalësuar qëkurse Trumpi u rikthye në Shtëpinë e Bardhë në janar të vitit 2025, megjithëse armët vazhdojnë të dërgohen përmes aleatëve evropianë - gjë që ka zemëruar Moskën.

I pyetur nëse Lavrovi i kishte kërkuar Uashingtonit ta ndalonte furnizimin me armë për Ukrainën, Rubio tha se politika amerikane nuk ka ndryshuar. Ai theksoi se ShBA-ja vazhdon të shesë armë përmes mekanizmave të NATO-s, ndërsa njëkohësisht vazhdon përpjekjet diplomatike.

“Ne duam që lufta të përfundojë. Jemi të gatshëm të luajmë çdo rol pozitiv që mundemi për t'i dhënë fund luftës”, tha Rubio.

Ai paralajmëroi se një marrëveshje do të kërkojë negociatë të gjata dhe jo vetëm një takim. “Kjo nuk do të ndodhë në një konferencë për shtyp. Nuk do të ndodhë në një takim këtu në Filipine”, tha ai.

Rubio shtoi se Trumpi mbetet i përqendruar në përfundimin e konfliktit, në mënyrë që “njerëzit të mos vdesin më”, Ukraina të mund të rindërtohet dhe ushtarët e rinj rusë të mos vazhdojnë të humbin jetën. “Ai mendon se kjo është luftë e kotë. Ai mendon se është një luftë e pakuptimtë”, tha Rubio.

I pyetur nga Radio Evropa e Lirë nëse Trumpi dhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky mund të takohen së shpejti, Rubio tha se zyrtarët amerikanë mbeten në kontakt të vazhdueshëm me Kievin dhe se janë takuar me përfaqësuesit ukrainas shumë më shpesh sesa me zyrtarët rusë.

Rubio tha, gjithashtu, se nuk e ka diskutuar luftën e Rusisë në Ukrainë me ministrin e Jashtëm të Kinës, Wang Yi, gjatë një takimi të veçantë pasi, sipas tij, të dyja palët kishin “shumë çështje të tjera për të diskutuar”.

BE-ja ARRIN PAJTUESHMËRI PËR PAKETËN E 21-të TË SANKSIONEVE KUNDËR RUSISË

BRUKSEL, 23 KORRIK - Vendet e Bashkimit Evropian janë pajtuar për paketën e 21-të të sanksioneve ndaj Rusisë për shkak të luftës së saj në Ukrainë, duke vendosur kufizime ndaj sektorit bankar rus, njëkohësisht duke arritur një kompromis me Greqinë për t'i zbutur kufizimet ndaj gazit të lëngshëm natyror (LNG) rus, thanë të enjten katër diplomatë të BE-së.

Paketa ofron një përjashtim njëvjeçar që u lejon kompanive të BE-së të transferojnë gaz të lëngshëm natyror nga Rusia drejt vendeve të treta, me mundësi rinovimi automatik,

pas kërkesave të Greqisë.

Për miratimin e sanksioneve kërkohej njëzëshmëria e shteteve anëtare. “Shtetet anëtare treguan solidaritet me Greqinë dhe pritjet që Greqia ta bëjë të njëjtën gjë me të tjerët në të ardhmen”, tha një diplomat i BE-së.

Athina tha se ndalimi i ardhshëm i shërbimeve të transferimit të LNG-së ruse drejt vendeve të treta thjesht do ta zhvendoste pjesën e tregut jashtë Evropës dhe nuk do të ndikonte në të ardhurat e Rusisë.

Masa pritej të hynte në fuqi më 1 janar. Importet e LNG-së ruse



nga BE-ja do të mbeten të ndaluara nga kjo datë. Greqia mbizotëron tregun evropian të transportit detar të LNG-së dhe është ndër aktorët më të

mëdhenj globalë në këtë fushë, duke konkurruar me Japoninë, Kinën dhe Shtetet e Bashkuara. Paketa përfshin ngrirjen për 12 muaj të kufirit të çmimit të

naftës ruse në 44.10 dollarë për fuçi. Një rishikim i planifikuar do ta kishte rritur kufirin e çmimit pas luftës në Iran, duke i siguruar Moskës të ardhura dukshëm më të larta.

“Ne po... ngrijmë për një vit rregullimin e kufirit të çmimit të naftës, në mënyrë që makineria ruse e luftës të mos përfitojë nga goditjet në treg”, shkroi në platformën X presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Paketa vendos në listën e sanksioneve 94 institucione financiare ruse - kryesisht banka - si dhe bursën e Moskës.

IKD NIS NISMËN PËR NDRYSHIMIN E KODIT PENAL, DUHEN 10 MIJË NËNSHKRIME PËR TA ÇUAR NË KUVEND

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka nisur zyrtarisht mbledhjen e nënshkrimeve për nismën legjislative qytetare që synon ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Për procedimin e kësaj nisme në Kuvend nevojiten së paku 10 mijë nënshkrime të qytetarëve. Hulumtuesi i lartë i IKD-së, Naim Jakaj, tha se nisma përmban dy propozime konkrete: që moszbatimi i qëllimshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të parashikohet si vepër penale dhe që përdorimi i parasë publike për përfitim elektoral gjatë periudhave zgjedhore dhe parazgjedhore të sanksionohet gjithashtu si vepër penale. Sipas Jakajt, këto ndryshime synojnë forcimin e llogaridhënies, mbrojtjen e rendit kushtetues dhe rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e shtetit. Ai tha se qytetarët meritojnë politika sociale të qëndrueshme dhe të bazuara në ligj, por shprehu shqetësimin për ndarjen e mjeteve publike pak para zgjedhjeve. "Paraja publike është e qytetarëve. Ajo duhet të përdoret për interes publik, jo për interesa partiake apo elektorale. Pikërisht për këtë

arsye propozojmë që përdorimi i parasë publike për përfitim elektoral të sanksionohet si vepër penale", deklaroi Jakaj. Duke folur për propozimin e dytë, ai tha se moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese cenon autoritetin e Kushtetutës dhe minon sundimin e ligjit. "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme. Kur ato nuk zbatohen, nuk cenohet vetëm një aktgjykim, por autoriteti i Kushtetutës", u shpreh Jakaj. Ai theksoi se nisma nuk është e drejtuar kundër ndonjë partie politike apo individi, por ka për qëllim forcimin e shtetit të së drejtës dhe integritetit zgjedhor. Sipas procedurës ligjore, pas mbledhjes së të paktën 10 mijë nënshkrimeve, nisma do t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës. Nënshkrimet do të verifikohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa më pas propozimi do t'i nënshtrohet shqyrtimit në Komisionin për Legjislacion dhe votimit në Kuvend. Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka thënë se do të jetë nënshkrues i kësaj nisme. "Edhe pse në një demokraci normale respektimi i Kushtetutës dhe mosshfrytëzimi i parasë publike janë norma standarde, abuzimi flagrant në vitet e



fundit po na imponon 'presionin' për rregullimin e tyre me ligj. Prandaj e mbështes nismën e IKD-së!", ka thënë Gjini në një postim në rrjetet sociale. Ai ka thënë se ndarja e parave publike disa ditë para

zgjedhjeve nuk është politikë sociale, është manipulim i pastër për të blerë vota të qytetarëve me paratë e tyre. "Zgjedhjet duhet të jenë garë e barabartë, jo një treg ku pushteti hyn në garë me buxhetin e shtetit në dorë.

Duhet të ketë përgjegjësi penale si për shkeljen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe për keqpërdorimin e parasë publike për fushata. Ky abuzim duhet të dënohet me ligj për këdo", është shprehur Gjini.

RAPORTI I D+: PROCEDURAT E PROKURIMIT PREJ 22.5 MILIONË EUROSH U SHOQËRUAN ME SHKELJE DHE ZVARRITJE

PRISHTINË, 23 KORRIK - Demokraci Plus (D+) ka publikuar raportin me titull "Kostoja e procedurave të papërfunduara: rivlerësime të përsëritura dhe mungesa e kontratave", i cili analizon ligjshmërinë, efikasitetin dhe transparencën e pesë procedurave të prokurimit publik me vlerë të përgjithshme prej 22.5 milionë eurosh. Sipas D+, raporti bazohet në monitorimin e procedurave të zhvilluara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)



dhe Ministria e Shëndetësisë (MSh). Në raport thuhet se janë evidentuar një sërë shkeljesh dhe praktikash problematike

që kanë ndikuar në zvarritjen e procedurave, anulimin e tyre ose moslidhjen e kontratave. Sipas D+, gjetjet përfshijnë "emërimin e parregullt të

anëtarëve të komisioneve të vlerësimit, paraqitjen e arsyeve të reja për eliminimin e operatorëve ekonomikë vetëm në fazën e rishqyrtimit, rekomandimin për dhënie të kontratës operatorëve me çmime jo normalisht të ulëta pa një vlerësim të plotë dhe të dokumentuar, si dhe shkurtimin e pajustifikuar të afateve ligjore për dorëzimin e ofertave". Raporti evidenton se disa procedura kanë mbetur të bllokuara për më shumë se dy vjet pavarësisht prej vendimeve të përsëritura të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), duke shkaktuar vonesa në realizimin

e kontratave dhe duke dëmtuar efikasitetin e shpenzimit të parasë publike. Bazuar në gjetjet e monitorimit, D+ rekomandon që autoritetet kontraktuese ta sigurojnë emërimin e ligjshëm të komisioneve të vlerësimit, ta respektojnë parimin e sigurisë juridike gjatë shqyrtimit të kërkesave për rishqyrtim, të bëjnë vlerësim të rregullt të ofertave me çmim jo normalisht të ulët, të garantojnë proporcionalitet dhe transparencë në procedurat e prokurimit si dhe t'i përfundojnë procedurat brenda afateve ligjore duke zbatuar në mënyrë efektive vendimet e OSHP-së.

150 euro në muaj për mjekët që punojnë vetëm në sektorin publik shëndetësor

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë vazhdon zbatimin e politikave që synojnë mbështetjen dhe motivimin e profesionistëve shëndetësorë, duke forcuar njëkohësisht

sistemin publik të kujdesit shëndetësor. Sipas një postimi në rrjetin social në "Facebook", thuhet se edhe këtë vit është nënshkruar vendimi për vazhdimin e shtesës prej 150

eurosh në muaj për mjekët që punojnë vetëm në sektorin publik shëndetësor. "Kjo politikë ka për qëllim të kontribuojë në fuqizimin e sektorit publik shëndetësor, duke vlerësuar angazhimin dhe

përkushtimin e mjekëve që angazhohen ekskluzivisht në sektorin publik. I falënderojmë për kontributin e tyre dhe u urojmë shëndet e suksese në punë", thuhet në njoftim.





KATËR VJET PAS LARGIMIT TË PROKURORËVE SERBË, KOSOVA PËRGATIT KONKURS TË RI

Prishtinë, 23 korrik - Gati katër vjet pasi dhjetëra gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës administrativë serbë u larguan nga institucionet e drejtësisë në veri të Kosovës, autoritetet po përgatiten të nisin një proces të ri për plotësimin e vendeve të mbetura bosh.

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) konfirmon për Radion Evropa e Lirë se është duke përgatitur konkursin për rekrutimin e prokurorëve nga radhët e komunitetit serb, pasi ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, dekretoi lirimin nga detyra të shtatë prokurorëve serbë që kishin dhënë dorëheqje në vitin 2022.

Në konkurs do të mund të aplikojnë të gjithë kandidatët që i plotësojnë kushtet ligjore, përfshirë edhe ish-prokurorët, të cilëve iu refuzua kërkesa për tërheqjen e dorëheqjeve. Vendimi shënon një kthesë në një çështje që kishte mbetur pezull për gati katër vjet por, njëkohësisht, ka nxitur kritika nga Bashkimi Evropian dhe dilema mes njohësve të drejtësisë nëse është marrë në momentin e duhur dhe nëse do ta ndihmojë apo do ta vështirësojë riintegrimin e

juristëve serbë në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

Pse u hap rruga për konkursin?

Më 21 korrik ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, nënshkroi dekretet për lirimin nga detyra të shtatë prokurorëve serbë që kishin dhënë dorëheqje në fund të vitit 2022, në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës. Dekreti u nënshkrua një ditë pasi Këshilli Prokurorial i Kosovës refuzoi kërkesën e pesë prokurorëve serbë dhe 15 punonjësve administrativë të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për të tërhequr dorëheqjet e tyre.

Prokurorët dhe gjyqtarët serbë kishin dhënë dorëheqje në fund të nëntorit 2022, në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës në katër komunat me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok.

Ky veprim - i nxitur nga Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, që mbështetet nga Beogradi - erdhi në shenjë kundërshtimi ndaj

vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i hequr nga përdorimi targat e automjeteve të lëshuara nga Serbia dhe për t'i zëvendësuar ato me targa të Kosovës.

Bashkimi Evropian reagoi duke thënë se vendimi i Haxhiut "nuk duket të jetë në përputhje me ligjin", pasi prokurorët kishin njoftuar më herët se dëshironin të riktheheshin në detyrë. Brukseli u bëri thirrje institucioneve të Kosovës të shmangin veprimet që mund të pengojnë riintegrimin e personelit gjyqësor serb. Ambasada amerikane në Prishtinë nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për koment, por në një reagim për mediat në Prishtinë, ajo rikujtoi se Kushtetuta e Kosovës garanton përfaqësimin e komunitetit serb në institucione dhe tha se pret që Qeveria e Kosovës të sigurojë mundësi të barabarta për pjesëtarët e këtij komuniteti.

KPK: Ish-prokurorët mund të aplikojnë sërish

Zëdhënësi i KPK-së, Bedri Gashi, thotë për Radion Evropa e Lirë se procesi i rekrutimit do të zhvillohet sipas legjislacionit në

fuqi dhe se konkursi do të jetë i hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore.

Ai konfirmon se kjo përfshin edhe ish-prokurorët, të cilëve iu refuzua kërkesa për tërheqjen e dorëheqjeve. "Procesi i rekrutimit do të zhvillohet përmes procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kriteret ligjore përkatëse", thotë Gashi.

KPK-ja nuk bëri të ditur se kur do të shpallet konkursi, duke thënë se afatet do të përcaktohen gjatë procedurës.

Çfarë do të ndodhë me gjyqtarët?

Ndryshe nga Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ende nuk ka marrë vendim për kërkesat e gjyqtarëve serbë që kanë kërkuar të tërheqin dorëheqjet e tyre. Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, KGJK-ja thotë se kërkesat do të shqyrtohen me kujdes dhe se publiku do të njoftohet pasi Këshilli të marrë vendim.

Institucioni nuk bën të ditur se sa gjyqtarë kanë kërkuar rikthimin në sistem, duke thënë se është ende në proces të

mbledhjes së të dhënave.

Bugaqku: Vendimi është ligjor, por vjen shumë vonë

Vullnet Bugaqku, njohës i çështjeve juridike nga Instituti Demokratik i Kosovës, thotë se ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, nuk ka bërë shkelje ligjore me dekretimin e lirimit nga detyra të prokurorëve serbë. Sipas tij, ajo vetëm ka formalizuar vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, i cili, në aspektin procedural, është marrë në përputhje me ligjin.

Megjithatë, ai vë në pikëpyetje legjitimitetin e vendimit, për shkak të kohës kur është marrë. "Në aspektin e legjitimitetit - se sa është marrë ky vendim në kohën e duhur dhe në një moment të përshtatshëm - lë shumë hapësirë për diskutim, për faktin se po merret pas katër vjetësh", thotë Bugaqku për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, kjo zvarritje lidhet si me zhvillimet politike në Kosovë, ashtu edhe me problemet e vetë KPK-së, e cila për një periudhë kishte vështirësi funksionimi për shkak të mungesës së kuorumit.

PHILLIPS: KOSOVËS I MUNGON PJEKURIA POLITIKE PËR TË QENË PARTNERE STRATEGJIKE

PRISHTINË, 23 KORRIK - Profesori i asociuar në Programin e Studimeve të Sigurisë në Universitetin Georgetown, David L. Phillips, ka kritikuar klasën politike dhe shoqërinë e Kosovës për mungesën e, siç e quajti ai, pjekurisë politike për të ndërtuar një partneritet strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në një intervistë për "Kallxo.com", Phillips tha se përgjegjësia për ngërcën institucionale në Kosovë nuk bie vetëm mbi liderët politikë, por edhe mbi shoqërinë, e cila, sipas tij, nuk kërkon mjaftueshëm llogari nga udhëheqja. "Shoqëria e Kosovës është përgjegjëse, sepse nuk kërkon më shumë nga udhëheqja e saj politike", deklaroi Phillips.

Duke komentuar marrëdhëniet Kosovë - ShBA dhe mundësinë e rifillimit të Dialogut Strategjik mes dy vendeve, ai sugjeroi që Prishtina të kërkojë emërimin e një të dërguari të posaçëm amerikan që do të punonte paralelisht me një përfaqësues të Bashkimit Evropian. "Kërkoni një të dërguar të posaçëm të ShBA-së që të punojë përkrah një homologu të Bashkimit Evropian", tha ai.

Megjithatë, Phillips shprehu kritika për gatishmërinë e Kosovës për të qenë partnere strategjike e Uashingtonit, sidomos në një kohë kur Serbia ka nisur Dialogun Strategjik me ShBA-në. "Kosovës i mungon pjekuria politike për të qenë partnere strategjike", deklaroi

profesori amerikan.

Ai foli edhe për projektin e gazit amerikan dhe paralajmëroi se vonesat mund të kenë pasoja për Kosovën. Sipas tij, administrata e presidentit Donald Trump i sheh marrëdhëniet ndërkombëtare edhe përmes interesave ekonomike dhe Prishtina duhet ta paraqesë veten si një aset ekonomik. "Trumpi është shumë transaksional. Kosova duhet ta paraqesë veten si një aset ekonomik", tha Phillips.

I pyetur nëse Kosova rrezikon ta humbasë mundësinë strategjike në sektorin e energjisë, ai u përgjigj shkurt: "Po".

Ndërkohë, Shtetet e Bashkuara kanë bërë me dije se Dialogu

Strategjik me Kosovën mund të rifillojë vetëm kur të krijohen kushtet e duhura dhe kur institucionet e vendit të jenë plotësisht funksionale.

Ambasada Amerikane në Prishtinë ka kërkuar hapa konkretë nga institucionet e Kosovës për përmbushjen e zotimeve, veçanërisht në raport me komunitetin serb në Kosovë. "Për të rifilluar planifikimin për një dialog strategjik, ne duam të shohim hapa konkretë nga qeveria në detyrë për ta çuar përpara qëllimin tonë të përbashkët për forcimin e paqes dhe stabilitetit", ka deklaruar Ambasada amerikane.

ShBA-ja e kishte pezulluar për një

kohë të pacaktuar planifikimin e Dialogut Strategjik me Kosovën në shtator të vitit 2025, duke përmendur shqetësime për veprimet e ndërmarra nga qeveria në detyrë.

Ndërkohë, Serbia ka nisur më 17 korrik raundin e parë të Dialogut Strategjik me ShBA-në. Ministri i Jashtëm serb, Marko Gjuriq, e ka cilësuar këtë zhvillim si një nga momentet më të rëndësishme në marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Uashingtonit.

Serbia, në kuadër të këtij bashkëpunimi, ka pranuar edhe projekte për gazin e lëngshëm natyror dhe diversifikimin e furnizimit energjetik.

Në Kosovë debati për projektin e

gazit amerikan vazhdon të jetë i hapur. Përfaqësues të ShBA-së kanë kërkuar partneritet afatgjatë energjetik me Prishtinën, ndërsa qeveria në detyrë ka deklaruar se nuk është kundër gazit amerikan, por se prioritetet energjetike të Kosovës kanë qenë thëngjilli, burimet e ripërtërishme, koogjenerimi dhe eficiencia energjetike.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, kishte deklaruar më herët se nuk bëhej fjalë për prishje të marrëdhënieve me ShBA-në, por vetëm për pezullim të planifikimit të Dialogut Strategjik. "Nuk jemi prishur me Amerikën, por kemi disa dallime", kishte thënë Kurti.



"Unë mendoj se përbërja e mëparshme e KPK-së nuk e pati as vullnetin dhe as guximin ta trajtonte këtë çështje. Me gjasë, ajo u pa si një temë politike që kërkonte koordinim më të gjerë ndërmjet institucioneve qendrore dhe institucioneve të drejtësisë - në këtë rast KPK-së dhe KGJK-së", shton Bugaqku.

Milliqeviq: Vendimi mund ta thellojë mosbesimin

Për Miodrag Milliqeviqin nga organizata joqeveritare Aktiv në Mitrovicë të Veriut, refuzimi i kërkesës së prokurorëve serbë për t'u rikthyer në detyrë, si dhe dekretimi i këtij vendimi nga ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, erdhën me vonesë dhe në një moment politikisht të ndjeshëm. Sipas tij, ky veprim bie ndesh me sinjalet që, muajt e fundit, një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare kishte dhënë për të inkurajuar rikthimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në institucionet e drejtësisë në Kosovë. "Ky është një vendim politik, i cili padyshim do ta thellojë jo vetëm jostabilitetin, por edhe mosbesimin e lartë të serbëve ndaj institucioneve

qendrore të Kosovës", thotë Milliqeviq për Radion Evropa e Lirë.

Megjithatë, ai vlerëson se përgjegjësia nuk bie vetëm mbi institucionet e Kosovës. Sipas tij, largimi kolektiv i zyrtarëve serbë nga institucionet në vitin 2022 ishte vetë një vendim i gabuar politik, i marrë nën drejtimin e Listës Serbe. "Komuniteti serb nuk është më ai që vendos i vetëm nëse do të rikthehet apo jo në institucione", thotë ai, duke nënvizuar se procesi tashmë është bërë shumë më kompleks. Milliqeviq beson se mënyra se si do të zgjidhet çështja e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë do të ndikojë jo vetëm në funksionimin e sistemit të drejtësisë, por edhe në marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë. Sipas tij, ajo mund të ndikojë edhe në qasjen e bashkësisë ndërkombëtare ndaj dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - një proces që ai e cilëson si të bllokuar. "Tashmë është pyetje e hapur se deri në çfarë mase mund të mbështetemi te marrëveshjet e arritura në dialog, nëse palët janë të gatshme t'i zbatojnë ato dhe nëse ekziston ende vullnet politik për t'i respektuar", thotë Milliqeviq.

Një proces i lidhur me Marrëveshjen e Brukselit

Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë së Kosovës nuk është vetëm një çështje e funksionimit të institucioneve.

Ai buron si nga Kushtetuta e Kosovës, e cila kërkon që përbërja e gjykatave dhe prokurorëve të pasqyrojë përbërjen etnike të zonave ku ushtrojnë juridiksionin, ashtu edhe nga marrëveshjet e arritura në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013 vendosi parimin e integritetit të sistemit të drejtësisë në veri të Kosovës. Dy vjet më vonë, Marrëveshja për Drejtësinë përcaktoi modalitetet për integrimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serb në institucionet e drejtësisë së Kosovës.

Zbatimi i këtij procesi nisi në tetor të vitit 2017, kur dhjetëra gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës administrativë serbë u integruan në sistemin e drejtësisë së Kosovës, në atë që u konsiderua si një nga rezultatet

më konkrete të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Dorëheqjet kolektive të zyrtarëve serbë në fund të vitit 2022 e ndërprejnë këtë proces.

Tash, me lirinim përfundimtar nga detyra të prokurorëve që dhanë dorëheqje dhe paralajmërimin për një konkurs të ri, institucionet synojnë t'i plotësojnë vendet vakante duke ruajtur përfaqësimin e komunitetit serb në sistemin e drejtësisë.

Konkursi mund të jetë zgjidhja ligjore, por jo edhe praktike

Për Bugaqkun, hapja e konkursit për plotësimin e vendeve vakante është rruga që parashikon ligji, por procesi duhet të garantojë përfaqësimin e komunitetit serb në sistemin e drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe marrëveshjet e arritura në dialogun Kosovë-Serbi. "Nuk ka asnjë pengesë ligjore që të njëjtit prokurorë, të cilët kanë shërbyer më parë dhe kanë dhënë dorëheqje, t'i nënshtrohen sërish konkursit. Natyrisht, procedura përfshin verifikimin e kriterëve ligjore,

kontrollin e integritetit, testimet dhe intervistat", thotë Bugaqku. Sipas Milliqeviqit, sfida kryesore nuk do të jetë organizimi i konkursit, por gatishmëria e juristëve serbë për t'u bërë pjesë e tij.

Ai beson se, në rrethana normale, plotësimi i vendeve vakante do të ishte një procedurë e zakonshme administrative. Por, në kushtet aktuale, çështja është bërë shumë më tepër politike sesa juridike. "Në këtë moment është vështirë të thuhet se sa persona do të aplikojnë. Më pas shtrohet pyetja nëse kandidatët do t'i plotësojnë kriteret e nevojshme për integrim në sistem dhe si do të zhvillohet i gjithë procesi", thotë ai.

Milliqeviq mbetet skeptik se prokurorët që u liruan nga detyra do të jenë të gatshëm të rikthehen në sistem përmes një konkursi të ri.

Nëse kjo ndodh, institucionet e Kosovës do të duhet të gjejnë kandidatët të rinj për të plotësuar vendet vakante, duke u përballur me sfidën e ruajtjes së karakterit multietnik të sistemit të drejtësisë dhe njëkohësisht me nevojën për të rikthyer besimin e komunitetit serb në institucionet e vendit.

KUVENDI I JASHTËZAKONSHËM I LDK-së NË “DISKRECION” TË ABDIXHIKUT

PRISHTINË, 23 KORRIK - Në Lidhjen Demokratike të Kosovës po përgatitet raporti për kërkesën e rreth 150 delegatëve për shkarkimin e kryetarit të partisë, Lumir Abdixhiku.

Sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ilir Ferati, i tha gazetës “Express” se ende s’e kanë njoftuar Abdixhikun formalisht për nënshkrimet. “Jo ende s’e kemi njoftuar zyrtarisht”, tha ai.

Ferati tha se po përgatisin një raport që do t’i dorëzohet kryetarit të LDK-së. “Jemi në përgatitje të raportit, i cili përfshin jo vetëm nënshkrimet, por edhe elemente teknike”, tha ai. Ai tha se nuk i takon atij ta thotë, kur u pyet nëse Kuvendi i jashtëzakonshëm i partisë do të mbahet javën e ardhshme. “Është në diskrecion të kryetarit ta caktojë se kur është më e përshtatshme”, tha Ferati.

Të mërkurën u verifikuan nënshkrimet e rreth 150 delegatëve të LDK-së që kërkojnë shkarkimin e kryetarit të partisë.

Një javë më parë nënshkrimet u dorëzuan në selinë qendrore të kësaj partie.

Pasi Abdixhiku të njoftohet zyrtarisht për verifikimin e nënshkrimeve, ai duhet ta caktojë datën e mbajtjes së Kuvendit të Jashtëzakonshëm, ku do të testohet besimi brendapartiak ndaj tij.

Para një jave në LDK nisi zyrtarisht nisja e brendshme për shkarkimin e kryetarit, me deputetin e zgjedhur Armend Zemaj, dhe kryetarin e degës së dytë të kësaj partie në Prishtinë, Florian Dushi, të cilët i dorëzuan nënshkrimet e grumbulluara.

Ditën kur u dorëzua kërkesa për shkarkimin e kryetarit, Abdixhiku njoftoi vetë në Facebook se ishin deponuar “148 nënshkrime të delegatëve” dhe se nisja bënte thirrje për mbajtjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm me kërkesën kryesore - largimin e tij nga karrigia e të parit në LDK.

Për shkak të kësaj nisje, Abdixhiku javën e kaluar i



pezulloi bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e institucioneve të reja. “Në këtë pikë, më duhet t’i njoftoj qytetarët e vendit tim se për shkak të kësaj nisje detyrohem t’i ndërpres të gjitha angazhimet për formimin e institucioneve të Republikës që i prisni me të drejtë tash e sa kohë”, ka thënë ai në një video-mesazh në “Facebook”. Në këto rrethana Abdixhiku ka thënë se “s’do të ishte as serioze dhe as e

përgjegjshme” që ai të vazhdonte të negocionte në emër të LDK-së, ndërkohë që mandati i tij për ta udhëhequr partinë “është vënë në diskutim nga brenda shtëpisë”. Ai ka thënë se nuk dëshiron të besojë se bisedimet me LV-në ishin arsyeja e “ngutisë për Kuvend të paprecedent”.

Nga këto zhvillime, sipas tij, “qytetarët e Kosovës do të pësojnë më së shumti” dhe “LDK bashkë me ta”, pasi ato vijnë “në një moment shumë kritik” për

këtë parti dhe për vendin. Ky proces i brendshëm, sipas Abdixhikut mund ta dëmtojë LDK-në “pariparueshëm nga brenda dhe ta lë Kosovën pa institucione dhe potencialisht përballë zgjedhjeve të reja në vjeshtë”.

Abdixhiku ka thënë se nuk ka frikë “nga vota e vendimi i delegatëve”, ndërsa ka përmendur “apetite” të kundërshtarëve të tij brenda partisë për “ta marrë karrigen e kryetarit”.

Anëtar i Kryesisë së LDK-së, Shkëmb Manaj, tha mbrëmë në RTV21 se Kuvendi do të mbahet “para seancës konstituive” të Kuvendit, e cila duhet të mbahet më së largu deri në fund të javës së parë të gushtit.

Kuvendi i Jashtëzakonshëm i LDK-së duhet të mbahet 60 ditë nga dita e dorëzimit të nënshkrimeve, sipas statutit të kësaj partie.

Kuvendi i LDK-së i ka 355 delegatë, përfshirë kryetarin.

NË KROACI ZBULOHEK PLLAKA PËRKUJTIMORE PËR 10 VIKTIMAT NGA KOSOVA TË AKSIDENTIT TRAGJIK TË VITIT 2021

PRISHTINË, 23 KORRIK - Në një ceremoni solemne të organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Republikën e Kroacisë, të enjten në Sllavonski Brod u zbulua pllaka përkujtimore kushtuar dhjetë viktimave që humbën jetën në aksidentin tragjik rrugor të 25 korrikut 2021, një nga ngjarjet më të rënda që preku qytetarët e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë.

Në ceremoni morën pjesë përfaqësuesi special i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, Genc Metaj, prefekti i Qarkut Brod-Posavinë, dr. Danijel Marušić, zëvendëskryetarja e Bashkisë së Slavonski Brodit, Martina Martić Puača, familjarë të viktimave, përfaqësues të institucioneve të të dy vendeve si dhe qytetarë të shumtë të cilët nderuan me respekt kujtimin e atyre që humbën jetën në këtë tragjedi.

Në fjalën e tij të rastit, ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën e Kroacisë, Martin



Berishaj, theksoi se zbulimi i kësaj pllake përkujtimore nuk është vetëm një akt simbolik, por një shprehje e përgjegjësisë sonë morale për ta ruajtur kujtesën ndaj viktimave dhe për të dëshmuar se dhimbja e familjeve të tyre mbetet edhe dhimbja jonë

e përbashkët.

Ai rikujtoi se atë mëngjes tragjik dhjetë familje mbetën pa më të dashurit e tyre, pesëmbëdhjetë persona pësuan lëndime të rënda, ndërsa tridhjetë të tjerë u lënduan më lehtë. “Pas këtyre shifrave nuk fshihen statistika, por fate

njerëzore, ëndrra të ndërprera, fëmijëri të këputura dhe familje, jeta e të cilave ndryshoi përgjithmonë”, u shpreh ambasadori Berishaj.

Më tej, ai theksoi se koha mund ta zbusë dhimbjen, por nuk mund ta shuajë kujtesën, prandaj vende si ky janë të domosdoshme për t’ua kujtuar brezave të ardhshëm se jeta e njeriut është e paçmueshme dhe se tragjeditë e tilla duhet të shërbejnë si thirrje për përgjegjësi dhe kujdes më të madh.

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Metaj, shprehu mirënjohjen e tij të thellë për Republikën e Kroacisë, institucionet e saj të sigurisë, ekipet emergjente dhe të gjitha palët që kontribuan me profesionalizëm dhe përkushtim në menaxhimin e aksidentit tragjik në të cilin humbën jetën 10 persona.

Ai u shprehu ngushëllimet më të sinqerta familjeve të viktimave, duke theksuar se dhimbja e tyre mbetet një humbje e përbashkët.

Sekretari nënvizoi se vendosja e kësaj pllake përkujtimore nuk është vetëm një akt nderimi për jetët e humbura, por edhe një kujtesë e përhershme për rëndësinë e mbrojtjes së jetës dhe shëndetit si dhe një thirrje për përgjegjësi dhe kujdes të shtuar, me qëllim që tragjedi të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Një falënderim i veçantë iu drejtua edhe Adnan Vuniqi, mbështetja bujare e të cilit bëri të mundur realizimin e këtij projekti përkujtimor.

Në fund të ceremonisë perfekti i Perfekturës Brod - Posavje dr Marušić përçoll një mesazh i veçantë për familjet e viktimave, duke u theksuar se asnjë fjalë nuk mund ta lehtësojë dhimbjen dhe zbrazëtinë që ato mbartin prej pesë vitesh, por se ato nuk janë vetëm në këtë pikëllim. U nënvizua se kjo pllakë përkujtimore do të mbetet një kujtesë e përhershme për vlerën e çdo jete njerëzore dhe një thirrje e përbashkët që tragjedi të tilla të mos përsëriten më.

Nëntë shqiptarë të Kosovës të vdekur nga aksidentet në trafik për vetëm shtatë ditë

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kosovën e ka përcjellë një javë me bilanc të rëndë në komunikacion. Brenda pak ditësh në disa aksidente të ndodhura në vende të ndryshme kanë humbur jetën nëntë persona.

Një nga rastet më të rënda të javës u regjistrua në Maqedoninë e Veriut, ku tre qytetarë të Kosovës humbën jetën në një aksident tragjik. Një tjetër aksident me pasojë fatale ndodhi në Istog, ku dy

persona humbën jetën. Rasti riktheu shqetësimet për gjendjen e sigurisë në rrugët e Kosovës dhe për faktorët që çojnë në aksidente të rënda.

Gjatë kësaj jave u raportuan edhe raste të tjera tragjike në komunikacion.

Në afërsi të Komoranit, një person humbi jetën në një vetaksident, ndërsa tre persona të tjerë mbetën të lënduar.

Në Shirokë të Suharekës, një

52-vjeçar ndërroi jetë pas një vetaksidenti, ndërsa në një rast tjetër, një grua humbi jetën disa ditë pas një aksidenti të rëndë në Mitrovicë.

Të enjten një tjetër viktimë iu shtua këtij bilanci pas aksidentit fatal në Studime të Vushtrrisë, ku një grua humbi jetën, ndërsa disa persona të tjerë u lënduan. Sipas dyshimeve fillestare, aksidenti lidhet me ngasjen në gjendje të dehur, ndërsa Prokuroria ka

nisur procedurat hetimore ndaj personit të dyshuar. Shpejtësia, moskujdesi gjatë ngasjes, drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit dhe mosrespektimi i rregullave të komunikacionit vazhdojnë të konsiderohen ndër faktorët kryesorë që shkaktojnë aksidente me pasojë të rënda.

Policia e Kosovës vazhdimisht ka bërë thirrje për kujdes të shtuar nga ana e drejtuesve të automjeteve, respektim të



kufizimeve të shpejtësisë dhe shmangie të çdo sjelljeje që mund ta rrezikojë jetën në rrugë.

AKK-ja KUNDËRSHTON PROJEKTLIGJIN PËR PRONËN PUBLIKE: PO CENOHEM KOMPETENCAT E KOMUNAVE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 23 korrik - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka shprehur shqetësimin lidhur me Projektligjin për Pronën Publike, duke vlerësuar se ai paraqet tendencë për centralizimin e kompetencave dhe cenimin e autonomisë së komunave. Sipas AKK-së, dispozitat e propozuara kufizojnë të drejtën e komunave për të poseduar, administruar dhe menaxhuar pronën e tyre, e cila, sipas këtij institucioni, përbën një nga shtyllat kryesore të vetëqeverisjes lokale. "Projektligji për pronën publike paraqet një tendencë shqetësuese të centralizimit të kompetencave dhe cenon një nga shtyllat themelore të vetëqeverisjes lokale, të drejtën e komunave për të poseduar, administruar dhe menaxhuar

pronën e tyre", është thënë në reagimin e AKK-së. AKK-ja ka vlerësuar se projektligji është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, konkretisht me nenin 14, i cili përcakton të drejtën e komunave për të poseduar dhe menaxhuar pronën e luajtshme dhe të paluajtshme. "Ky projektligj nuk është në frymën e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, e cila garanton autonominë lokale dhe mbrojtjen e kompetencave të komunave", është thënë në reagim. Sipas Asociacionit, përmes këtij projektligji komunave mund t'u kufizohen kompetencat në administrimin e pronës komunale, ndërsa niveli qendror do të ketë kontroll më të madh mbi asetet që shërbejnë për zhvillimin lokal. AKK-ja ka theksuar se prona

komunale nuk është vetëm një aset administrativ, por përbën bazë për zhvillimin ekonomik dhe realizimin e projekteve me interes publik. "Prona komunale është baza e zhvillimit ekonomik lokal. Përmes saj, komunat planifikojnë zhvillimin urban, krijojnë zona ekonomike, tërheqin investime, ndërtojnë shkolla, çerdhe, qendra shëndetësore, rrugë, objekte sportive e kulturore dhe realizojnë projekte të tjera me interes publik", është thënë në reagimin e AKK-së. Në reagim Asociacioni ka ngritur shqetësime edhe për vendimet e mëhershme të nivelit qendror, të cilat, sipas tij, kanë shkaktuar pasoja financiare për komunat. "Komunat nuk mund të përballen njëkohësisht me barrë gjithnjë e më të madhe financiare nga vendimet e nivelit qendror dhe, në anën tjetër, t'u



kufizohen kompetencat që u garantohen me ligj", është thënë në reagim. AKK-ja i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të mos procedojë miratimin e këtij projektligji pa zhvilluar një dialog të mirëfilltë me komunat dhe pa e harmonizuar atë me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Kartën Evropiane të

Vetëqeverisjes Lokale. "Autonomia lokale nuk është privilegj i komunave, por garanci kushtetuese për qytetarët. Mbrojtja e pronës komunale është mbrojtje e decentralizimit, e zhvillimit ekonomik lokal dhe e një shteti demokratik, ku kompetencat respektohen në çdo nivel të qeverisjes", është thënë në reagimin e AKK-së.

DY ZYRTARË ARRESTOHEN NËN DYSHIMIN SE LËSHUAN LEJE QËNDRIMI NË KOSOVË NË KËMBIM TË PËRFITIMIT FINANCIAR

Prishtinë, 23 korrik - Autoritetet në Kosovë njoftuan se i kanë ndaluar dy zyrtarë të Ministrisë së Brendshme, nën dyshimin se kanë anashkaluar ligjin, duke u lëshuar leje qëndrimi në Kosovë disa të huajve në këmbim të përfitimit financiar. Prokuroria Themelore në Prishtinë shkroi në "Facebook" se dy zyrtarët janë ndaluar për 48 orë dhe se akuzohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Policia dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë i arrestuan ata së bashku me një person tjetër të mërkurën pas një hetimi disamujor në këtë çështje, tha Prokuroria. Arrestimi i tyre u përshëndet nga ministri i Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla. Një nga zyrtarët e arrestuar punon në Divizionin për të Huaj, ndërsa tjetri në Agjencinë e Regjistrimit Civil, thuhet në njoftim. Hetimet fillestare tregojnë se zyrtarët e dyshuar, F. Sh., dhe G. J., "kanë lëshuar leje qëndrimi për shtetas të huaj, duke u



mundësuar atyre të pajisen me dokumentacionin përkatës, përmes të cilit dyshohet se kanë

përfituar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme". Ndërkaq i dyshuari me inicialet

D. K. dyshohet se ka falsifikuar dokumente të ndryshme me qëllim që t'u mundësojë

personave të tjerë të aplikojnë dhe të pajisen në mënyrë të kundërligjshme me leje qëndrimi në Kosovë, tha tutje Prokuroria. Prokuroria nuk tregoi se sa të huaj janë pajisur me leje qëndrimi në këtë rast apo se sa kanë përfituar zyrtarët e dyshuar. Sveçla shkroi në "Facebook" se e mirëpret vendimin për ndalimin e zyrtarëve të ministrisë së tij, duke thënë se "ne mbetemi të përkushtuar ndaj parimeve të integritetit, ligjshmërisë dhe llogaridhënies së çdo zyrtari publik". "Luftimi i korrupsionit dhe garantimi i integritetit institucional janë parakushte thelbësore për ofrimin e shërbimeve të drejta, efikase dhe transparente për qytetarët. Askush nuk do të lejohet ta përdorë pozitën zyrtare për përfitime personale në dëm të interesit publik dhe të drejtave të qytetarëve për trajtim të barabartë para institucioneve", tha Sveçla.

Dhjetë oficerë të FSK-së diplomojnë në Akademinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë

PRISHTINË, 23 KORRIK - Bazuar në marrëveshjen e arritur ndërmjet shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji dhe komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, në tetor të vitit 2025 filloi Kursi Përgatitor për Oficer, në të cilin morën pjesë dhjetë kandidatë nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Kadetët e FSK-së diplomuan të mërkurën në ceremoninë solemne të diplomimit të

gjeneratës 2026 të kadetëve të Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ceremonia u zhvillua në praninë e kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe me pjesëmarrjen e drejtuesve të institucioneve të mbrojtjes dhe sigurisë të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Kjo arritje shënon një tjetër hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit ushtarak dhe zhvillimit profesional të udhëheqësve të rinj. Oficerët e

diplomuar kanë përfunduar me sukses programin akademik dhe ushtarak, duke fituar njohuri të avancuara në fushën e udhëheqjes, planifikimit operacional, vendimmarrjes dhe menaxhimit ushtarak në përputhje me standardet e NATO-s. Forca e Sigurisë së Kosovës mbetet e përkushtuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të saj, me synim ngritjen e kapaciteteve operative dhe forcimin e ndërveprueshmërisë me forcat partnere dhe aleate.



NË QERSHOR KOSOVA EKSPORTOI 102 MILIONË EURO MALLRA, IMPORTOI MBI 680 MILIONË EURO

PRISHTINË, 23 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin qershor 2026.

Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 16,1 % në muajin qershor 2026, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2025, gjegjësisht në vlerë prej 578,3 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 498,3 milionë eurosh në vitin 2025. Eksporti mbulon importin me 15 %.

Eksporti i mallrave në muajin qershor 2026 kishte vlerën 102 milionë euro, ndërsa importi 680,3 milionë euro, që është një rritje prej 26,9 % për eksport, si dhe një rritje prej 17,6 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 27,4 % e përbëjnë metalet bazë dhe

artikujt prej tyre; 12,7 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,6 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 8,7 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 7,1 % e përbëjnë produktet minerale etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 15,2 % e përbëjnë produktet minerale; 13 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12 % e përbëjnë mjetet e transportit; 11,9 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 9,8 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 32,5 milionë euro, ose rreth 31,9 % e



eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 17,7 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (10,1 %), Holanda (3,8 %), Italia (3,1) etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 304,9 milionë euro, ose 44,8 % e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 22,2 %. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (13,3 %), Italia

(8,6 %), Polonia (4,3 %), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 44 milionë euro, ose 43,1 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 19,3 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e

Veriut (16,7 %), Shqipëria (14,3 %), Mali i Zi (5,7 %), Serbia (4 %) etj.

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 98,7 milionë euro, ose 14,5 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 19,3 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (5,4 %), Shqipëria (4,8 %), Serbia (3 %).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 25,5 milionë euro, ose 25 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (10 %) dhe Turqia (5,4 %).

Importet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 276,7 milionë euro, ose 40,7 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (15,1 %) dhe Turqia (11,6 %).

UP-JA NËNSHKRUAN MEMORANDUM ME MINISTRINË E BUJQËSISË PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË BUJQËSISË

PRISHTINË, 23 KORRIK - Universiteti i Prishtinës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me të cilin krijohet një kornizë bashkëpunimi për çështjet me interes të përbashkët dhe të mirën publike.

Memorandumi parashikon aktivitetet të përbashkëta dhe bashkëpunim ndërinstitucional në fushat me interes të dyanshëm. Ai synon forcimin e kapaciteteve, përmirësimin e politikave publike, përafrimin me politikat e BE-së dhe përfshirjen e dijes akademike të UP-së në mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe



zhvillimit rural.

Memorandumi u nënshkrua nga rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu dhe ministri në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural, Armend Muja.

Rektori Hajrullahu tha se të dy institucionet duhet të ndihmojnë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Duke u ndërlidhur me pronat e lirë

nga uzurpimi të Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, rektori konstatoi se nuk mjafton vetëm parandalimi i së keqes, por duhet edhe të bëhen punë të mira. Rektori theksoi se prona publike duhet të mbetet publike, e kurrësi të lejohet uzurpimi e tjetërsimi.

Ministri Muja nënshkrimin e memorandumit e konsideroi si hap të parë shumë të rëndësishëm për të dy institucionet. Ai paralajmëroi edhe një plan pune të përbashkët për realizimin e marrëveshjes. Ministri përmendi shërbimin kombëtar të këshillimeve në bujqësi, sigurinë ushqimore dhe një qendër për

paralajmërimin e hershëm të stuhive të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, si fusha ku roli i Universitetit të Prishtinës do të jetë kyç.

Universiteti i Prishtinës me qëllimin e ofrimit të ekspertizës për punët dhe të mirën e përgjithshme publike e të shoqërisë, sivjet nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Drejtësisë, dhe Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit.

NJË HAP I RËNDËSISHËM NË BASHKËPUNIMIN NDËRMJET KOSOVËS DHE GJERMANISË PËR VEPRIMIN KLIMATIK DHE TRANZICIONIN ENERGJETIK

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës, së bashku me GIZ Kosovo, kanë nënshkruar zyrtarisht Marrëveshjen e Zbatimit për projektin “Mbështetje për Partneritetin për Tranzicionin Klimatik dhe Energjetik”.

Marrëveshja forcon bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë në avancimin e politikave klimatike dhe agjendës së tranzicionit energjetik. Ajo bazohet në bashkëpunimin ekzistues dhe synon një koordinim më të ngushtë ndërmjet partnerëve,

duke përfshirë forcimin e dialogut politik, kapaciteteve institucionale, diplomacisë klimatike dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Gjithashtu, ajo mbështet përpjekjet e përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe nxitjen e angazhimit më të gjerë për adresimin e ndryshimeve klimatike dhe avancimin e tranzicionit energjetik, duke ndihmuar në shndërrimin e prioritetëve të përbashkëta në veprime konkrete në nivel institucional dhe shoqëror.

Sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë, Leonita Shabani Mullarama, u shpreh se ky partneritet përbën një hap të rëndësishëm në



forcimin e bashkëpunimit dhe në përshejtimin e përpjekjeve për një tranzicion energjetik të qëndrueshëm. “Bashkëpunimi me partnerët tanë ndërkombëtarë është thelbësor për avancimin e agjendës klimatike dhe energjetike. Përmes këtij projekti ne do të

vazhdojmë t'i forcojmë kapacitetet tona institucionale dhe të punojmë drejt zbatimit të politikave që mbështesin një të ardhme më të qëndrueshme energjetike për qytetarët”, tha sekretarja e përgjithshme. Ky partneritet është një tjetër dëshmi e marrëdhënieve

shumëvjeçare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë dhe pasqyron përkushtimin e përbashkët për ta mbështetur rrugëtimin e Kosovës drejt integritimit evropian. Duke i shndërruar prioritetet strategjike në veprime konkrete, ky partneritet përfaqëson një hap të rëndësishëm në rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Projekti mbështetet nga Ministria Federale Gjermane për Mjedisin, Veprimin Klimatik, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore (BMUKN), përmes Nismës Ndërkombëtare për Klimën (IKI) dhe zbatohet nga GIZ Kosovë.

ELON MUSK SFIDON NOLANIN PËR FILMIN 'ODISEA': 'DO TË BËJ NJË VERSION MË TË MIRË ME GROK'



Elon Musk ka sfiduar Christopher Nolanin dhe u ka premtuar kritikëve të regjisorit të filmit "Odisea" një version të ri të sagës së Uliksit, "historikisht më besnik" dhe të realizuar tërësisht me inteligjencë artificiale.

Pasi kaloi disa muaj duke sulmuar filmin epik të Nolanit – me komente që u kritikuan për tone raciste – pavarësisht kastit të yjeve ku bëjnë pjesë Matt Damon, Anne Hathaway, Zendaya dhe Lupita Nyong'o, themeluesi i Tesla-s dhe SpaceX njoftoi se modeli i tij i inteligjencës artificiale, Grok, do të prodhojë një film artistik "besnik ndaj veprës së Homerit" deri në fund të këtij viti, në kohë për sezonin e ardhshëm të çmimeve kinematografike.

Postimi i Musk në rrjetin X u shoqërua me një video të shkurtër prej tre minutash, të krijuar nga një prej ndjekësve të tij, ku me Grok ishte gjeneruar një kast aktorësh të

gjithë me ngjyrë të bardhë.

Më pas, Musk miratoi me një koment të shkurtër "jam dakord" propozimin e një tjetër ndjekësi, sipas të cilit duhej t'i jepeshin 100 milionë dollarë Mel Gibson-it për të realizuar një version të ri të "Odisesë", "me anije, armatura, armë dhe një kast historikisht të saktë, me të gjithë dialogët të marrë nga poema origjinale dhe të recituar në greqishten homerike".

Musk është përpjekur të nxisë një përplasje kulturore rreth filmit të Nolanit, ku Matt Damon interpreton Uliksin dhe Anne Hathaway Penelopën. Filmi u shfaq në kinema të premtën, u prit me vlerësime pothuajse unanime nga kritika dhe pati një debutim shumë të suksesshëm në arkate botërore.

Përpara daljes së filmit, Musk ripostoi komente fyese që kritikoni zgjedhjen e regjisorit Christopher Nolan për të besuar rolin e Helenës së

Trojës dhe Klitemnestrës aktore me ngjyrë Lupita Nyong'o, si edhe rolin e Sinonit aktorit transgjinnor Elliot Page. Musk shtoi se "Nolani po e bën këtë për të fituar çmimet" dhe se "ka humbur integritetin e tij artistik".

Megjithatë, përpjekjet e Musk duket se kanë pasur pak ose aspak ndikim. "Odisea" arkëtoi 264 milionë dollarë në fundjavën e parë të shfaqjes në kinematë e botës dhe mori një vlerësim prej 97% nga publiku në Rotten Tomatoes.

Në muajin maj, Lupita Nyong'o iu përgjigj kritikëve të krahut të djathtë duke deklaruar: "Kasti ynë përfaqëson botën ku jetojmë. Nuk kam ndërmend të harxhoj kohën time duke u mbrojtur. Kritikat do të ekzistojnë, pavarësisht nëse unë u përgjigjem apo jo."

Së fundmi, edhe Christopher Nolan komentoi reagimet negative, duke thënë se ato "janë pjesë e lojës". "Këto diskutime

që zhvillohen para se njerëzit ta kenë parë filmin janë gjithmonë të parëndësishme, sepse askush nga ata që marrin pjesë në to nuk e di ende se çfarë është në të vërtetë filmi."

Reagime ndaj Elon Musk

Fushata e Elon Musk kundër filmit "Odisea" të Christopher Nolanit ka ngjallur habi në Hollywood.

Një nga zërat më kritikë nga komuniteti i kinemasë ishte regjisor i "Doctor Strange" dhe "The Black Phone", Scott Derrickson, i cili nuk i kurseu fjalët ndaj Musk në rrjetet sociale.

Duke shkruar në platformën X, në pronësi të vetë Musk, Derrickson deklaroi: "Është e qartë se @elonmusk nuk kupton asgjë nga kinemaja dhe ka pushuar së lexuari libra që në të njëzetat e tij. Opinione të tij për artin nuk kanë asnjë vlerë." Themeluesi i Tesla-s ka sulmuar filmin "Odisea" të

Christopher Nolanit shumë kohë përpara daljes së tij në kinema, për shkak të disa zgjedhjeve "woke", sipas tij, në përzgjedhjen e aktorëve.

Në mars, Musk shkroi se "Christopher Nolan është një racist kundër të bardhëve", pasi zgjodhi Lupita Nyong'o për rolin e Helenës së Trojës. Sipas tij, regjisor i mori këtë vendim sepse "kërkon të fitojë çmime". Ai sulmoi edhe Elliott Page, i cili interpreton rolin e Sinonit në "Odisea", duke ripostuar komente që talleshin me identitetin dhe maskulinitetin e aktorit transgjinnor.

Megjithatë, "Odisea" nuk është filmi i parë që Musk ka kritikuar në platformën X. Më parë ai kishte ironizuar edhe filmin "Barbie" për mesazhet e tij feministe, si dhe ribërjen e "Borëbardhës" nga Disney, me Rachel Zegler në rolin kryesor. Por reagimi kundër asaj që kritikët e quajnë qasje "woke" nuk duket se pati ndikim te suksesi i filmit.

'DHJETËRA MILIARDA DOLLARË'. MARRËVESHJA BËRTHAMORE SHBA-ARABIA SAUDITE



Programi është për përdorim civil, por nga marrëveshja bërthamore Mbretëria mund të fitojë edhe të drejtën për pasurimin e uranimit. Kjo ngre shqetësime serioze për përhapjen e teknologjisë bërthamore.

Donald Trump ka kërcënuar sërish se do të godasë ura dhe objekte energjetike në Iran – madje edhe në kryeqytetin Teheran – sa herë që regjimi iranian sulmon një anije në Ngushticën e Hormuzit.

Irani është përgjigjur duke deklaruar se, për çdo infrastrukturë iraniane që goditet, do të hakmerret ndaj objekteve dhe impianteve energjetike në vendet e Gjirit Persik. Këto të fundit janë tashmë objektiv i sulmeve me dronë dhe raketa iraniane, si kundërpërgjigje ndaj bombardimeve amerikane, të cilat vazhduan edhe për natën e njëmbëdhjetë radhazi.

Ndërkohë, presidenti amerikan ka dhënë dritën jeshile për një marrëveshje, e cila ishte negociuar gjatë javës së kaluar dhe u firmos dje nga sekretari amerikan i Energjisë, Chris

Wright.

Marrëveshja i jep Arabisë Saudite mundësinë të zhvillojë një program bërthamor për qëllime civile dhe, potencialisht, i hap rrugën edhe pasurimit të uranimit brenda territorit të saj.

Lajmi ishte publikuar paraprakisht nga Wall Street Journal dhe New York Times. Bëhet fjalë për një marrëveshje me vlerë të vlerësuar në dhjetëra miliarda dollarë. Ajo u jep kompanive amerikane një rol qendror në ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës bërthamore saudite për 30 vitet e ardhshme.

Këto kompani mund të ndërtojnë edhe një impiant për pasurimin e uranimit, por vetëm nëse një studim i përbashkët amerikano-saudit, që do të zgjasë rreth dy vjet, arrin në përfundimin se është ekonomikisht më e leverdishme që uranumi të pasurohet në Arabinë Saudite, në vend që lënda djegëse bërthamor të blihet jashtë vendit.

Nëse studimi jep një rezultat pozitiv, impiantet do të ndërtohen nga kompanitë

amerikane, pa transferuar teknologji të ndjeshme tek Arabia Saudite.

Nëse Shtetet e Bashkuara e kundërshtojnë më vonë këtë hap, Riadi nuk do të ketë të drejtë, për një periudhë 10-vjeçare, të ndërtojë vetë ose me partnerë të tjerë të huaj impiante për pasurimin e uranimit. Sipas Shtëpisë së Bardhë, kjo formulë u garanton SHBA-ve ndikim të vazhdueshëm mbi programin bërthamor audit dhe shërben si një mekanizëm për të parandaluar përdorimin e tij për qëllime ushtarake.

Megjithatë, në Kongresin amerikan, si republikanë ashtu edhe demokratë, ka zëra që kundërshtojnë prej kohësh përhapjen e teknologjisë bërthamore në Lindjen e Mesme.

Megjithatë, do të jetë e vështirë që marrëveshja të bllokohet. Për ta rrëzuar atë do të nevojitej një rezolutë e përbashkët e Kongresit, e miratuar me shumicë prej dy të tretash, nëse do të ishte e nevojshme të kapërcehej një veto e mundshme presidenciale.

Lufta me Iranin ka krijuar tensione mes Uashingtonit dhe Riadit, por kjo marrëveshje synon të forcojë marrëdhëniet strategjike, duke shmangur rrezikun që Arabia Saudite t'i drejtohet Rusisë ose Kinës për zhvillimin e programit të saj bërthamor.

Megjithatë, nëse marrëveshja nuk përmban kufizime të forta dhe mekanizma efektivë kontrolli, ajo mund të rrisë rrezikun e përhapjes së armëve bërthamore.

Nga Izraeli kanë ardhur reagime të forta shqetësimi. Përfaqësues të shumicës qeverisëse dhe të opozitës kanë deklaruar se shteti hebre duhet të bëjë gjithçka që është në fuqinë e tij për të penguar zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Për princin e kurorës, Mohammed bin Salman, kjo është një fitore e madhe.

Prej vitesh ai kërkon një marrëveshje të tillë për të diversifikuar ekonominë saudite, e cila vazhdon të mbështetet kryesisht tek nafta. Administrata Biden ishte e gatshme ta pranonte një marrëveshje të ngjashme vetëm


në këmbim të normalizimit të marrëdhënieve mes Arabisë Saudite dhe Izraelit.

Vetë Mohammed bin Salman kishte deklaruar që në vitin 2018 se, nëse Irani do të zhvillonte armë bërthamore, Arabia Saudite do të ndiqte të njëjtën rrugë.

Ndryshe nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabia Saudite ka refuzuar të marrë angazhimin për të mos pasuruar uranum në territorin e saj dhe për të mos ripërpunuar karburantin e përdorur nga reaktorët bërthamorë.

Një precedent i tillë mund të shtyjë edhe vende të tjera të rajonit, si Emiratet, Turqinë dhe Egjiptin, të kërkojnë të njëjtin trajtim. Arabia Saudite ka refuzuar gjithashtu të pranojë Protokollin Shtesë të Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA), i cili parashikon inspektime shumë më të repta të objekteve bërthamore.

Dhe lind pyetja: nëse Arabia Saudite përfiton kushte më të favorshme, përse Irani duhet të pranojë kufizime më të ashpra se rivali i tij kryesor rajonal? / bota.al



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Ballkani mposhtet në Dublin, por kualifikimi mbetet i hapur

DUBLIN, 23 KORRIK - Ballkani është mposhtur me rezultat 2:1 nga skuadra irlandeze Bohemians në ndeshjen e parë të raundit të dytë kualifikues të UEFA Conference League të zhvilluar në Dublin. Skuadra

nga Kosova ka kaluar e para në epërsi në minutën e 29, kur Toni Domgjoni është treguar i saktë nga pika e bardhë, duke i dhënë avantazhin Ballkanit. Vendasit kanë barazuar shifrat në minutën e 76 me anë të

Douglas James-Taylor, ndërsa golin e fitores për Bohemians e ka realizuar Ross Tierney në minutën e 89, me një gjuajtje të fortë nga distanca. Pavarësisht prej humbjes, Ballkani mbetet ende me shpresa për

kualifikim, pasi ndeshjen e kthimit do ta zhvillojë pas një jave në stadiumin "Fadil Vokrri", ku do të synojë ta përmbysë rezultatit dhe ta sigurojë kalimin në raundin tjetër.




MITROVICA SHKËLQEN NË SFIDËN E PARË TË LIGËS SË KAMPIONËVE, TRIUMFON ME REZULTAT TË THELLË NDAJ ZIMBRU CHISINAU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kampionia e Kosovës në futbollin e femrave, Mitrovica, e ka nisur në mënyrën më të mirë aventurën evropiane, duke shënuar fitore bindëse në raundin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve. Në ndeshjen gjysmëfinale të këtij raundi, të zhvilluar në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, skuadra mitrovicase ka mposhtur kampionen e Moldavisë, Zimbru Chisinau, me rezultat të thellë 10:0 dhe ka siguruar kualifikimin në finalen e raundit të parë kualifikues. Protagoniste kryesore e kësaj fitoreje madhështore ishte Edona

Kryeziu, e cila realizoi katër gola, duke udhëhequr skuadrën drejt suksesit. Paraqitje të shkëlqyer ka pasur edhe Aurora Mulliqi, autore e tre golave, ndërsa Ambra Gjergji, Blerta Shala dhe Bardha Mahmuti kanë kontribuar me nga një gol. Me këtë fitore, Mitrovica ka bërë hapin e parë drejt objektivit të saj në garat evropiane dhe tashmë do të përballlet në finalen e raundit të parë kualifikues me kampionen e Bullgarisë, Ludogorets. Skuadra bullgare ka siguruar vendin në finale pas fitores 3:0 ndaj KI Klaksvik nga Ishujt Faroe, në ndeshjen e zhvilluar në Podujevë.



GENOA INTERESOHET PËR MARIO MITAJN



GENOA, 23 KORRIK - Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Mario Mitaj, mund të transferohet në Serinë A gjatë afatit kalimtar të verës. Sipas gazetarit të njohur italian Gianluca Di Marzio, Genoa ka bërë kërkime për 21-vjeçarin,

por një transferim i mundshëm konsiderohet i vështirë për shkak të kërkesave financiare të Al-Ittihadit dhe nivelit të pagave në Saudi Pro League. Mitaj i ishte bashkuar Al-Ittihadit nga Lokomotiva e Moskës dhe deri më tani ka regjistruar 32

paraqitje me fanellën e Kombëtares së Shqipërisë, duke u shndërruar në një nga mbrojtësit më premtues shqiptarë. Skuadra e drejtuar nga Daniele De Rossi synon t'i përforcojë krahët e mbrojtjes dhe nuk përjashtohet mundësia

që negociatat të rifillojnë nëse klubi italian vendos të paraqesë një ofertë zyrtare. Për momentin, interesi i Genoas mbetet konkret, por realizimi i marrëveshjes varet nga kushtet financiare që do të kërkojë Al-Ittihad.

ZIDANE PARAQITET TRAJNER I FRANCËS MË 28 KORRIK



PARIS, 23 KORRIK - Federata Franceze e Futbollit (FFF) ka njoftuar se më 28 korrik do të mbahet një konferencë për medie ku do të paraqitet trajneri i ri i Kombëtares së Francës, Zinedine Zidane. Didier Deschamps është larguar nga pozita pas përfundimit të

Kupës së Botës 2026, ndërsa Zidane pritet të jetë pasuesi i tij. Federata Franceze e Futbollit ka bërë me dije se Zidane do të paraqitet zyrtarisht gjatë konferencës për medie që do të mbahet të martën e javës së ardhshme. "Presidenti i Federatës Franceze të

Futbollit, Philippe Diallo, do të mbajë një konferencë për shtyp këtë të martë, më 28 korrik 2026, duke filluar nga ora 11:00, në selinë e FFF-së, është thënë në njoftim. Pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit Ekzekutiv, e cila do të mbahet po atë mëngjes, Philippe Diallo do

t'ua paraqesë medieve trajnerin e ardhshëm të Kombëtares së Francës. Epoka e Zinedine Zidane pritet të nisë kështu në krye të "Les Bleus", pas eliminimit të hidhur në gjysmëfinalen e Kupës së Botës 2026 dhe humbjes ndaj Anglisë në ndeshjen për vendin e tretë.

Casemiro bëhet bashkëlojtar i Messit tek Inter Miami

MIAMI, 23 KORRIK - Pas disa sezoneve te Manchester Unitedi, mesfushori brazilian Casemiro ka nënshkruar zyrtarisht me Inter Miamin. Braziliani, i cili për shumë vjet ka luajtur së bashku me Cristiano Ronaldon, tani do ta ketë mundësinë të luajë edhe përkrah Lionel Messit.

Inter Miami, përmes një komunikate zyrtare, ka njoftuar transferimin e Casemiros, i cili ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2027, me opsion vazhdimi deri në vitin 2029. "Inter Miami njofton se ka nënshkruar me mesfushorin brazilian Casemiro. Pesë herë fituesi i Ligës së Kampionëve i

bashkohet klubit si lojtar i lirë deri në vitin 2027, me opsion për ta vazhduar kontratën deri në vitin 2029", ka njoftuar Inter Miami. Ndërsa Casemiro është shprehur i motivuar për ta dëshmuar veten në aventurën e tij të re. "Jam shumë mirënjohës dhe mezi pres t'ia filloj punës për ta

shpërblyer besimin, jo vetëm gjatë 90 minutave, por edhe në stërvitje. E tëra që mund të them është faleminderit", është shprehur ai. Casemiro periudhën më të suksesshme të karrierës e ka kaluar te Real Madridi, ku ka fituar të gjithë trofetë e mundshëm, përfshirë pesë tituj të Ligës së Kampionëve.



**NJOFTIM**
**Licencimi i Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e
Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë (Erës)**

Subjekti juridik i regjistruar në ARBK si **EV Wind Park SH.P.K.** me seli në Zatriq, me adresë Rr. Agim Ramadani, Nr. 125, kat 2/4 Komuna e Prishtinës, për gjeneratorin e energjisë elektrike të quajtur **EV Win Park Zatriq 1** me kapacitet **35 MW** në lokacionin Zatriq komuna e Rahovecit, nëpërmjet këtij NJOFTIMI informom palët e interesuara se ka APLIKUAR në Zyrën e Rregullatorit për Energji për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga Turbinat e Erës (WIND PARK ZATRIC 1) me kapacitet prej 35 MW, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017).

Aplikacioni për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, me dokumentet relevante, është dorëzuar pranë Zyra e Rregullatorit për Energji për shqyrtim sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Pas licencimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji, i licencuari mund të kryej aktivitetin e prodhimit të energjisë në Kosovë, në pajtim me dispozitat e licencës, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh pune, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë (portal). Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. "Bekim Fehmiu" (ndërtesa e Arting), Kati i II-të, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: LEGAL-LENCING@cro-ks.org Tel.038247615/101.

EV WIND PARK SHPK

Rr. Agim Ramadani, Nr. 125, kat 2/4

Data: 23.07.2026

ELBER SHAHOLLI
SH.P.K.
"EV Wind Park"
RAHOVEC

**NJOFTIM**
**Licencimi i Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e
Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë (Erës)**

Subjekti juridik i regjistruar në ARBK si **EV Wind Park SH.P.K.** me seli në Zatriq, me adresë Rr. Agim Ramadani, Nr. 125, kat 2/4 Komuna e Prishtinës, për gjeneratorin e energjisë elektrike të quajtur **EV Win Park Zatriq 2** me kapacitet **35 MW** në lokacionin Zatriq komuna e Rahovecit, nëpërmjet këtij NJOFTIMI informom palët e interesuara se ka APLIKUAR në Zyrën e Rregullatorit për Energji për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga Turbinat e Erës (WIND PARK ZATRIC 2) me kapacitet prej 35 MW, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017).

Aplikacioni për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, me dokumentet relevante, është dorëzuar pranë Zyra e Rregullatorit për Energji për shqyrtim sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Pas licencimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji, i licencuari mund të kryej aktivitetin e prodhimit të energjisë në Kosovë, në pajtim me dispozitat e licencës, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh pune, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë (portal). Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. "Bekim Fehmiu" (ndërtesa e Arting), Kati i II-të, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: LEGAL-LENCING@cro-ks.org Tel.038247615/101.

EV WIND PARK SHPK

Rr. Agim Ramadani, Nr. 125, kat 2/4

Data: 23.07.2026

ELBER SHAHOLLI
SH.P.K.
"EV Wind Park"
RAHOVEC

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "CBS Kosovo" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812197318 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "CBS Kosovo" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812197318 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "CBS Kosovo" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812197318 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda".

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjumnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjumnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

